FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al
www.qpz.gov.al

Nr.187 29 dhjetor 2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 026, datë 11.12.2008	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së grantit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës të objektivit strategjik për të luftuar korrupsionin, në kuadër të programit fillestar të vlerësimit të sfidës së mijëvjeçarit (faza e dytë)"……..	9225
Vendim i KM nr.1593, datë 3.12.2008	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për konvertimin e lejeve të drejtimit……	9242

LIGJ
Nr.10 026, datë 11.12.2008

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS TË OBJEKTIVIT STRATEGJIK PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN, NË KUADËR TË PROGRAMIT FILLESTAR TË VLERËSIMIT TË SFIDËS SË MIJËVJEÇARIT (FAZA E DYTË)"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e grantit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës të objektivit strategjik për të luftuar korrupsionin, në kuadër të programit fillestar të vlerësimit të sfidës së mijëvjeçarit (Faza e dytë)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5975, datë 18.12.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

USAID- Marrëveshje granti nr.182-SOAG-08-001-00

PROGRAMI FILLESTAR I LLOGARISË SË SFIDËS SË MIJËVJEÇARIT
MARRËVESHJE GRANTI E OBJEKTIVIT STRATEGJIK NDËRMJET
SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN
(FAZA II)

Datë 29 shtator 2008

Marrëveshje granti e objektivit strategjik ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që veprojnë nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave (këtu më poshtë referuar si "Marrësi i Grantit" apo "Qeveria").

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje granti të objektivit strategjik (Marrëveshja) është krijimi i mirëkuptimit nga palët e emërtuara më sipër (Palët) në lidhje me objektivin strategjik të përshkruar më poshtë.

Neni 2
Objektivi strategjik dhe rezultatet

Seksioni 2.1 Objektivi strategjik. Objektivi strategjik ("Objektivi strategjik" ose "Objektivi") është ulja e korrupsionit, si edhe fuqizimi i shtetit ligjor.

Seksioni 2.1 mund të mos ndryshohet, përveçse me anë të amendimit formal me shkrim të kësaj Marrëveshjeje nga përfaqësuesit e autorizuar, siç përcaktohet në seksionin 7.3.

Seksioni 2.2 Rezultatet. Me qëllim arritjen e objektivit, Palët bien dakord të punojnë së bashku për të arritur rezultatet e mëposhtme (secili referuar si "Rezultati" dhe së bashku si "Rezultatet"):

a) ulja e korrupsionit dhe zgjerimi i shtetit ligjor në procedurat e gjykatave administrative;

b) arritja e transparencës dhe ulja e korrupsionit në administratën tatimore;

c) lufta kundër korrupsionit në procedurat e licencimit të bizneseve dhe në administratë;

d) ulja e korrupsionit në procedurat e dhënies së lejeve të ndërtimit;

e) përmirësimi i hetimeve dhe ndjekjeve penale në rastet që kanë të bëjnë me korrupsionin; dhe

f) mbështetja e shoqërisë civile në monitorimin e përpjekjeve të qeverisë kundër korrupsionit.

Seksioni 2.2 mund të mos ndryshojë, përveç amendimit formal me shkrim të kësaj Marrëveshjeje nga ana e përfaqësuesve të autorizuar.

Seksioni 2.3 Shtojca 1, përshkrim i zgjeruar. Shtojca 1 që ndodhet bashkëngjitur është pjesë e kësaj Marrëveshjeje dhe jep në mënyrë të plotë dhe të zgjeruar objektivin dhe rezultatet e mësipërme. Brenda kufijve të përkufizimeve të mësipërme të objektivit në seksionin 2.1 dhe rezultateve në seksionin 2.2, shtojca 1 mund të ndryshohet vetëm me anë të një marrëveshjeje me shkrim të përfaqësuesve të autorizuar, pa amendimin formal të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3
Kontributet e Palëve

Seksioni 3.1 Kontributi i USAID-it granti. Për të ndihmuar arritjen e objektivit të parashtruar në këtë Marrëveshje, USAID-i, sipas kushteve të paraqitura në këtë Marrëveshje dhe sipas aktit të ndihmës së huaj të vitit 1961, siç është amenduar dhe seksionit 616 të Aktit të Sfidës së Mijëvjeçarit të vitit 2003, i jep Marrësit të grantit një shumë që nuk i tejkalon pesëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e tridhjetë e një mijë dollarë amerikanë (US) ($ 15 731 000) (Granti).

Seksioni 3.2 Kontributi i Marrësit të grantit. Marrësi i grantit do të sigurojë ose do të nxisë sigurimin e të gjitha fondeve, përveç atyre të siguruara nga USAID-i dhe ndonjë donator tjetër i identifikuar në shtojcën 1 dhe të gjitha burimet e tjera të kërkuara për të përfunduar të gjitha veprimtaritë e nevojshme për arritjen e rezultateve në datën e përfundimit ose para saj. Mbështetja ndaj Marrësit të grantit do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm te të gjitha kostot organizative që shoqërojnë arritjen e rezultateve.

Neni 4
Data e përfundimit

a) Data e përfundimit, 31 janar 2011, ose ndonjë datë tjetër sipas miratimit me shkrim të Palëve, është data në të cilën Palët vlerësojnë se do të përfundojnë të gjitha veprimtaritë e nevojshme për arritjen e objektivit dhe rezultateve.

b) Përveç rasteve kur USAID-i mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim, USAID-i nuk do të lëshojë ose miratojë dokumentacion që do të autorizonte disbursimin e grantit për shërbime të kryera ose mallra të furnizuara pas datës së përfundimit.

c) Kërkesat për disbursim, të shoqëruara me dokumentacionin mbështetës të nevojshëm, të parashikuar në dokumentet e zbatimit, duhet të merren nga USAID jo më vonë se nëntë (9) muaj pas datës së përfundimit ose në një periudhë tjetër, sipas miratimit me shkrim nga ana e USAID-it. Pas kësaj periudhe, USAID, në çdo kohë, mund të njoftojë me shkrim Marrësin e grantit dhe të ulë shumën e grantit për të gjithë ose një pjesë të tij, për të cilat nuk janë marrë kërkesat për disbursim para mbarimit të asaj periudhe, të shoqëruara me dokumentacionin mbështetës të nevojshëm të parashikuar në dokumentet e zbatimit.

Neni 5
Kushtet që i paraprijnë disbursimit

Seksioni 5.1 Disbursimi i parë. Para disbursimit të parë sipas grantit ose me lëshimin nga ana e USAID-it të dokumentacionit sipas të cilit do të bëhet ky disbursim, Marrësi i grantit, përveç rasteve kur Palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim, do t'i japin USAID-it në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të:

a) Një opinion ligjor të Ministrisë së Drejtësisë që kjo Marrëveshje është autorizuar në mënyrën e duhur ose e ratifikuar dhe ekzekutuar në emër të Marrësit të grantit dhe që ajo përbën një detyrim të vlefshëm dhe të ligjshëm të Marrësit të grantit, në përputhje me të gjitha kushtet e saj; si dhe

b) Një deklaratë në emër të personit që është në detyrën ose që vepron si Marrësi i grantit, specifikuar në seksionin 7.3 dhe të ndonjë përfaqësuesi shtesë të Palëve, së bashku me një model nënshkrimi të secilit person, specifikuar në këtë deklaratë.

Seksioni 5.2 Njoftimi. USAID-i do të njoftojë menjëherë Marrësin e grantit në lidhje me kohën kur USAID-i ka konstatuar që është plotësuar një kusht pararendës.

Seksioni 5.3 Datat përfundimtare për kushtet pararendëse. Data përfundimtare për plotësimin e kushteve të specifikuara në seksionin 5.1 është gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë datë e mëvonshme që do të vendoset sipas miratimit me shkrim të USAID-it. Nëse kushtet pararendëse në seksionin 5.1 nuk janë plotësuar deri në datën përfundimtare të mësipërme, USAID-i mund t'i japë fund Marrëveshjes me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Marrësit të grantit.

Neni 6
Marrëveshje e posaçme

Marrësi i grantit do të punësojë personelin e nevojshëm shtesë, të sigurojë zyra dhe të marrë masat e nevojshme rregulluese dhe ligjore për zbatimin e suksesshëm të të gjitha veprimtarive të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7
Të ndryshme

Seksioni 7.1 Disbursimi financiar. Veprimtaritë e parashikuara në këtë Marrëveshje do të ndërmerren në përputhje me rregullat, rregulloret, politikat dhe procedurat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, dhe USAID-i do t'ua disbursojë të gjitha fondet, sipas kësaj Marrëveshjeje, partnerëve zbatues (siç përcaktohet në shtojcën 1) në përputhje me këto rregulla, rregullore, politika dhe procedura.

Seksioni 7.2 Komunikimi. Çdo njoftim, kërkesë, dokument ose komunikim tjetër që secila Palë i dorëzon Palës tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë: a) me shkrim ose me anë të telegramit, telefaksit ose telegrafit; dhe b) do të konsiderohet e dhënë ose e dërguar kur i dërgohet asaj Pale në adresën e mëposhtme:

DREJTUAR USAID-IT:
Adresa postare:
Mission Director (Drejtuesi i misionit)
United States Agency for International Development
Embassy of the United States of Albania
Rr.Elbasanit 103
Tirana, Albania
Telefaks: +355-4-223-3520
Drejtuar Marrësit të grantit:
Adresa postare:
Ministri Ridvan Bode
Ministria e Financave
Blvd. "Dëshmorët e Kombit" nr.4,
Tiranë, Shqipëri

Telefax: +355-4-222-8405/8494

Të gjitha këto komunikime do të jenë në gjuhën angleze, përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe me shkrim. Adresat e tjera mund të zëvendësojnë ato të dhëna më sipër në bazë të dorëzimit të një njoftimi paraprak Palës tjetër.

Seksioni 7.3 Përfaqësuesit. Për të gjitha qëllimet që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje, Marrësi i grantit do të përfaqësohet nga personi që mban postin ose vepron si Ministër i Financave dhe USAID-i do të përfaqësohet nga personi që mban postin ose vepron si Drejtuesi i Misionit, USAID/Shqipëri (secili referohet si "përfaqësues i autorizuar" dhe së bashku si "Përfaqësuesit e autorizuar"). Secili prej përfaqësuesve të autorizuar, me anë të një njoftimi me shkrim, mund të caktojnë përfaqësues shtesë (Përfaqësuesit shtesë) për të gjitha qëllimet, përveç nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, nënshkrimit të amendimeve formale të Marrëveshjes ose ushtrimit të kompetencave sipas seksionit 2.3 për të ndryshuar shtojcën 1. Emrat e Përfaqësuesit të autorizuar dhe përfaqësuesve shtesë të Marrësit të grantit, me modelin e nënshkrimit, do t'i jepen USAID-it dhe ky i fundit mund të pranojë si të autorizuar çdo instrument të nënshkruar nga këta përfaqësues në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, deri në marrjen e njoftimit me shkrim të revokimit të autoritetit të tyre.

Seksioni 7.4 Shtojca e dispozitave standarde. "Një shtojcë e dispozitave standarde" (Shtojca 2) i bashkëngjitet dhe bëhet pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.5 Amendimet Për sa kohë që nuk specifikohet ndryshe, Palët mund ta amendojnë këtë Marrëveshje vetëm me anë të një amendimi me shkrim të nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar.

Në dëshmi të kësaj, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Marrësi i grantit, secili duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar, kanë bërë që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në emrat e tyre dhe të dërgohet në ditën dhe vitin e cituar më sipër.

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS	QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Nga: _____	Nga: _____
Emri: Roberta Mahoney	Emri: Ridvan Bode
Pozicioni: Drejtore e Misionit, USAID/Shqipëri	Pozicioni: Ministër i Financave

SHTOJCA 1
PËRSHKRIM I ZGJERUAR

I. HYRJE

Shtojca 1 përshkruan veprimtaritë që do të ndërmerren dhe rezultatet që duhen arritur me fondet e detyrueshme sipas kësaj Marrëveshjeje. Asgjë në shtojcën 1 nuk do të interpretohet si amendim i ndonjë prej përkufizimeve ose kushteve të Marrëveshjes.

II. HISTORIKU

Pritet që Shqipëria të përfundojë programin e saj fillestar prej 13.85 milionë dollarësh amerikanë më 15 nëntor të vitit 2008. Ky program u fokusua në reduktimin e korrupsionit në politikat dhe administratën tatimore, prokurimet publike, si edhe në regjistrimin e bizneseve.

Në dhjetor të vitit 2007, Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC) e ftoi Shqipërinë të merrte

pjesë në programin e dytë fillestar (Faza II), i cili do të mbështeste reformat e vazhduara të politikave si një mënyrë për të ndihmuar Shqipërinë për t'u bërë kandidate për marrjen e asistencës MCC Compact.

Në prill të vitit 2008, Qeveria i paraqiti MCC-së Planin Kombëtar Fillestar të Fazës II në të cilin parashtrohet strategjia e saj për luftën kundër korrupsionit, fuqizimin e shtetit ligjor, si edhe përmirësimin e lirisë ekonomike. Në gusht të vitit 2008, MCC-ja e miratoi asistencën për programin fillestar për Shqipërinë siç përshkruhet në këtë Marrëveshje (Programi).

III. OBJEKTIVI STRATEGJIK

Objektivi strategjik i kësaj Marrëveshjeje është ulja e korrupsionit, fuqizimi i shtetit ligjor dhe përmirësimi i lirisë ekonomike në Shqipëri.

IV. KOMPONENTËT E PROGRAMIT- Rezultatet dhe veprimtaritë e propozuara:

Programi përbëhet nga gjashtë komponentë:

- Ulja e korrupsionit dhe përmirësimi i shtetit ligjor në procedurat e gjykatave administrative (Gjykatat administrative);
- Arritja e transparencës dhe ulja e korrupsionit në administratën tatimore (Reformat e administratës tatimore);
- Lufta kundër korrupsionit në licencimin e bizneseve (Qendra Kombëtare e Licencimit të Bizneseve);
- Lufta kundër korrupsionit në dhënien e lejeve të ndërtimit. (Regjistri Kombëtar i Planifikimit);
- Përmirësimi i zbatimit të ligjit dhe ndjekjeve penale për rastet që kanë të bëjnë me korrupsionin (Njësitë e përbashkëta të hetimit); si edhe
- Mbështetja e shoqërisë civile në monitorimin e përpjekjeve të qeverisë kundër korrupsionit (Mbështetja e Shoqërisë Civile në monitorimin e përpjekjeve të qeverisë kundër korrupsionit).

Komponenti 1. Gjykatat administrative: Në shkurt të vitit 2008, u miratua një ligj i ri për pushtetin gjyqësor, që parashikonte krijimin e gjykatave administrative si pjesë e reformës së zgjeruar të sistemit gjyqësor. Ky komponent i programit do të ndihmojë në krijimin e këtyre gjykatave të specializuara për të trajtuar dhe zgjidhur çështje të tilla si ato tatimore dhe doganore, si edhe apelimet ndaj prokurimeve.

Qëllimi: Rritja e kapaciteteve gjyqësore, reduktimi i mundësive për korrupsion, si edhe krijimi i besimit në vetvete tek investuesit duke mbështetur ngritjen e sistemit të gjykatave administrative.

Veprimtaritë e propozuara:

- Trajnimi i gjyqtarëve administrativë të sapo rekrutuar, prokurorëve dhe avokatëve në drejtim të legjislacionit të ri mbi të drejtën administrative.
- Hartimi i udhëzuesve apo manualëve për administratorët publikë të cilët do të jenë përdoruesit e sistemit të gjykatave administrative.
- Sigurimi i mbështetjes dhe pajisjeve teknike për gjykatën administrative të Tiranës.
- Përshtatja e sistemit kombëtar të administrimit të çështjeve për gjykatën e re administrative për të ndjekur ecurinë e çështjeve nga regjistrimi deri në zgjidhjen përfundimtare të tyre.

- Futja e masave të transparencës në gjykatën administrative (p.sh. nxjerrja e listës së çështjeve gjyqësore në Internet (*online*), publikimi i të gjitha vendimeve në Internet (*online*), regjistrimet me audio dhe video të seancave gjyqësore, arkivat elektronikë të gjykatës).
- Realizimi i përfshirjes dhe edukimit të publikut në lidhje me sistemin e gjykatave administrative.

Rezultatet e pritshme:

- Efikasiteti i administrimit të çështjeve do të rritet nga regjistrimi i çështjes deri në zgjidhjen përfundimtare të saj me afërsisht dy të tretat, nga 94 ditë në 30 ditë. (Burimi: Të dhënat administrative qeveritare).
- 10 çështje administrative gjyqësore do të gjykohen vitin e parë nga gjykata; 40 të tilla pas vitit të dytë. (Burimi: Të dhënat administrative qeveritare).
- Perceptimi i sistemit gjyqësor do të përmirësohet nga 40 për qind (2008) në 55 për qind (2010). (Burimi: Studimi i USAID-it për korrupsionin në Shqipëri; të anketuarit kanë "pak" apo "shumë" besim te sistemi gjyqësor).

Komponenti 2. Reformat në administratën tatimore: Miratimi i ligjit mbi procedurat e reja

tatimore në maj të vitit 2008 i hapi rrugën në Shqipëri reformimit të administratës tatimore për t'u bërë më transparente, më efikase dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ky komponent do ta ndihmojë zbatimin e këtij ligji, si edhe konsolidimin e përfitimeve relative në drejtim të regjistrimit të tatim-taksave, si edhe shlyerjes së tyre në kuadrin e fazës së parë të programit fillestar.

Qëllimi: Krijimi i një administrate tatimore moderne që do të pakësojë kontaktet personale ndërmjet taksapaguesve dhe zyrtarëve, si edhe do të fuqizojë vjeljen e taksave dhe tatimeve ndërkohë që integriteti i sistemit mbetet i pacenuar.

Veprimtaritë e propozuara:

- Riorganizimi i administratës tatimore përgjatë linjave funksionale dhe gjeografike në bazë të ligjit për procedurat e reja tatimore.
- Hartimi i manualëve operativë për funksionet specifike të administratës tatimore si edhe trajnimi i 1000 inspektorëve tatimorë dhe orientimi i tyre në lidhje me skemën e re organizative dhe funksionale.
- Ngritja e një njësie të brendshme hetimi kundër korrupsionit brenda administratës tatimore.
- Ngritja e një njësie hetimi penal brenda administratës tatimore për të siguruar zbatimin e ligjeve kundër evazionit dhe mashtrimit fiskal.
- Krijimi i një këshilli konsultativ të taksapaguesve për të institucionalizuar konsultimin mes administratës tatimore dhe publikut.
- Hapja e zyrës së avokatit të taksapaguesve për të mbrojtur të drejtat e taksapaguesve.
- Krijimi i seksionit tatimor në gjykatën e re administrative.
- Zgjerimi i regjistrimit dhe pagesave në formë elektronike (*online)* të tatim-taksave për të gjithë taksapaguesit.
- Ngritja e qendrave të shërbimit të edukimit dhe informacionit.
- Krijimi i një sistemi elektronik për përzgjedhjen e deklaratave tatimore në bazë të analizës së rrezikut.

Rezultatet e pritshme:

- Të ardhurat tatimore në raport me produktin e brendshëm bruto do të rriten nga 23.6 për qind në 28 për qind. (Burimi: Ministria e Financave).
- Renditja e Shqipërisë përsa i përket "pagimit të tatim-taksave" do të përmirësohet nga vendi i 118-të në atë të 75-të. (Burimi: Raporti i Bankës Botërore i vitit 2008 mbi zhvillimin e Biznesit).
- Njësia Kundër Korrupsionit do të procedojë me sukses të plotë 60 çështje deri në fund të vitit të dytë. (Niveli bazë: 0) (Burimi: Të dhënat administrative qeveritare).

Komponenti 3. Qendra Kombëtare e Licencimit të Biznesit: Sapo një biznes regjistrohet në Shqipëri, ai ka shpesh nevojë për një ose më shumë licenca për të operuar. Gjatë dy viteve të fundit, Komisioni (Task Force) i Posaçëm Qeveritar për Reformën Rregullatore ka punuar për të reduktuar numrin e licencave që kërkohen dhe për të rekomanduar reformat e nevojshme, si edhe një projektligj që synon zbatimin e këtyre reformave pritet që të shndërrohet në ligj në vitin 2008. Ky komponent do ta mbështesë reformën e licencimit, duke pakësuar kështu mundësitë për korrupsion dhe duke rritur efikasitetin e krijimit të një biznesi funksional.

Qëllimi: Ngritja e Qendrës Kombëtare të Licencimit të Biznesit, ndërtimi i një sistemi të thjeshtuar për të dhënë licenca për veprimtaritë ekonomike duke përdorur *one-stop shop-et* si një mënyrë për të pakësuar mundësitë për korrupsion.

Veprimtaritë e propozuara:

- Krijimi i një sistemi të efektshëm licencimi si edhe ngritja e Qendrës Kombëtare të Licencimit të Biznesit për të përpunuar aplikimet e standardizuara për licenca.
- Realizimi i përfshirjes së publikut duke i shpjeguar qytetarëve reformat e licencimit nëpërmjet promovimit të Qendrës së re Kombëtare të Licencimit të Biznesit.
- Sigurimi i granteve për organizatat joqeveritare për të monitoruar reformën e licencimit.

Rezultatet e pritshme:

- Kohëzgjatja mesatare për miratimin e licencës do të reduktohet nga 331 ditë në më pak se 120 ditë. (Burimi: Raporti i Bankës Botërore i vitit 2008 mbi zhvillimin e biznesit).
- Numri mesatar i fazave të miratimit të licencës do të reduktohet nga 24 në më pak se 10. (Burimi: Raporti i Bankës Botërore i vitit 2008 mbi zhvillimin e biznesit).
- Numri i bizneseve të licencuara dhe të regjistruara te tatimet do të rritet nga 124 424 në 200 000. (Burimi: Të dhënat administrative qeveritare).

- Renditja e Shqipërisë në raportin mbi zhvillimin e biznesit do të përmirësohet nga vendi i 168-të (2008) në më pak se ai i 50-të (2010). (Burimi: Raporti i Bankës Botërore i vitit 2008 mbi zhvillimin e biznesit).

Komponenti 4. Regjistri Kombëtar i Planifikimit: Në bazë të këtij komponenti, qeveria do të zbatojë procedura vendimmarrëse transparente në procesin e dhënies së lejeve të ndërtimit, duke hartuar, ndërmjet të tjerave, një regjistër elektronik të kodeve të planifikimit të ndërtimit, si edhe për udhëzimet dhe njoftimet.

Qëllimi: Krijimi i një regjistri kombëtar elektronik të efektshëm për lejet e zhvillimit dhe ndërtimit, duke reduktuar në këtë mënyrë mundësitë për korrupsion në sektorin e ndërtimit.

Veprimtaritë e propozuara:

- Krijimi i një Regjistri Kombëtar të Planifikimit, një burim elektronik të dhënash për kodet e planifikimit dhe ndërtimit, udhëzimet dhe njoftimet.
- Projektimi i programeve të regjistrit, krijimi i një baze të dhënash për sistemin e informacionit gjeografik, si edhe hartimi i akteve nënligjore mbi Regjistrin Kombëtar të Planifikimit.
- Hartimi i një plani trajnimi për personelin e Regjistrit Kombëtar të Planifikimit.
- Trajnimi i 400 ekspertëve në nivel kombëtar dhe lokal në lidhje me sistemin e ri të regjistrimit të ndërtimeve.

Rezultatet e pritshme:

- Kohëzgjatja e miratimit të lejeve të ndërtimit do të reduktohet nga 331 në 30 ditë. (Burimi: Raporti i Bankës Botërore i vitit 2008 mbi zhvillimin e biznesit).
- Numri i procedurave për miratimin e lejes së ndërtimit do të reduktohet nga 24 në 4. (Burimi: Raporti i Bankës Botërore i vitit 2008 mbi zhvillimin e biznesit).

Komponenti 5. Njësitë e Përbashkëta të Hetimit: Në vitin 2007, Prokuroria e Përgjithshme shtoi përpjekjet e saj për të ndjekur penalisht krimet që lidhen me korrupsionin dhe ato ekonomike duke krijuar një Njësi të Përbashkët Hetimi në Tiranë, të përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Brendshme dhe asaj të Financave, si edhe nga Shërbimi Kombëtar Informativ. Ky komponent do ta çojë më tej suksesin fillestar të Njësisë së Përbashkët të Hetimit të Tiranës duke e shtrirë atë edhe në rajonet jashtë kryeqytetit.

Qëllimi: Fuqizimi i përpjekjeve kundër korrupsionit nëpërmjet krijimit të qendrave të përbashkëta të hetimit në prokuroritë e gjashtë rretheve administrative jashtë Tiranës, si edhe zhvillimi i veprimtarive për të rritur sensibilizimin e publikut në lidhje me njësitë e reja.

Veprimtaritë e propozuara:

- Ngritja e njësive speciale brenda Prokurorisë së Përgjithshme në Shkodër, Durrës, Fier, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastër për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet që lidhen me korrupsionin dhe ato ekonomike.
- Pajisja dhe sigurimi i mbështetjes për hapjen e zyrave për këto njësi.
- Hapja e një zyre trajnimi dhe zhvillimi i moduleve të trajnimit për njësitë e hetimit.
- Trajnimi i prokurorëve dhe punonjësve të policisë për krimet ekonomike dhe korrupsionin.
- Sigurimi i granteve për organizatat joqeveritare dhe institucionet edukative për të rritur sensibilizimin e publikut në lidhje me përpjekjet e bëra për zbatimin e ligjeve kundër korrupsionit.

Rezultatet e pritshme:

- Do të iniciohen 100 ndjekje penale për çështje që lidhen me korrupsionin dhe krimin financiar. (Vlera bazë (2008): 62 individë në vitin 2008) (Burimi: Të dhënat administrative qeveritare).
- Do të arrihet në dhënien e 60 dënimeve për ndjekjet penale të bazuara në investigimet e njësive të përbashkëta të hetimit. (Vlera bazë: 26 individë në vitin 2008) (Burimi: Të dhënat administrative qeveritare).

Komponenti 6.Monitorimi nga shoqëria civile e përpjekjeve të qeverisë kundër korrupsionit:

Qëllimi: Mbështetja e shoqërisë civile në monitorimin e përpjekjeve të qeverisë kundër korrupsionit, si edhe për të shërbyer si mbrojtëse dhe përkrahëse e përmirësimit të këtyre përpjekjeve atje ku është e nevojshme.

Veprimtaritë e propozuara:

- Akordimi i fondeve për organizatat joqeveritare, organizatat e shoqërisë civile, si edhe për

shoqatat e tjera për monitorimin e përpjekjeve të qeverisë në luftën kundër korrupsionit, si edhe për të shërbyer si mbrojtëse dhe përkrahëse e përmirësimit të këtyre përpjekjeve atje ku është e nevojshme. Atje ku është e përshtatshme mund të përdoren kontrata në vend të granteve.

Rezultatet e pritshme:

- Fuqizimi i përmirësimit të aftësive dhe efikasitetit të aktorëve joqeveritarë.
- Grupet apo shoqatat përfituese do të përfshihen gjithmonë e më shumë në përpjekjet për reforma dhe do të shohin një lëvizje në drejtim të sigurimit të vetëqëndrueshmërisë ekonomike nëpërmjet kuotave të anëtarësisë dhe burimeve të tjera. Ndryshimi në këto fusha do të matet në krahasim më të dhënat bazë të përcaktuara përpara se të fillojë zbatimi i veprimtarive.

V. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

A. QEVERIA

Në lidhje me kryerjen e veprimtarive në bazë të kësaj Marrëveshjeje, qeveria do të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar arritjen e rezultateve dhe objektivave, ashtu siç parashikohet në këtë Marrëveshje.

Në vijim, por pa u kufizuar në ato që u cituan më sipër, qeveria do të: a) paguajë pagat vjetore dhe kostot organizative të personelit të qeverisë, të caktuar për mbikëqyrjen dhe zbatimin e programit dhe të veprimtarive përkatëse; b) sigurojë zyrat për personelin e partnerëve zbatues të përzgjedhur (siç përcaktohet më poshtë); c) sigurojë monitorimin e programit; dhe d) sigurojë mbështetjen e buxhetit dhe përsëritjen e mësimeve të nxjerra për të mbështetur veprimtaritë e programit pas datës së përfundimit dhe për t'u zgjeruar në fushat e tjera.

B. USAID-I

USAID-i do të punojë bashkë me Qeverinë (specifikisht me zëvendëskryeministrin) për të asistuar qeverinë në zbatimin e suksesshëm të programit dhe për arritjen e rezultateve dhe objektivit të parashikuar në këtë Marrëveshje. Në bazë të qëllimit të programit, parashikohet që organizmat pjesëmarrës qeveritarë do të përfshijnë Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Ministrinë e Drejtësisë, si edhe Ministrinë e Brendshme. Në varësi të nevojave në zhvillim të programit, mund të shtohen organizma të tjerë gjatë zbatimit të tij. Departamenti Amerikan i Drejtësisë, Departamenti Amerikan i Shtetit, si edhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë do të luajnë rolin kryesor gjatë zbatimit të programit.

USAID-i do të lidhë një ose më shumë marrëveshje me një ose më shumë partnerë zbatues si palë e tretë (secili, referuar si "Partner zbatues") për zbatimin e programit. Këto marrëveshje mund të përfshijnë grante, marrëveshje bashkëpunimi dhe kontrata. Partnerët zbatues mund të jenë vendas, Shtetet e Bashkuara, organizata ndërkombëtare ose shumëkombëshe, qeveritare ose joqeveritare, si edhe individë. USAID-i do t'i përzgjedhë partnerët zbatues, në përputhje me rregulloret dhe politikat e USAID-it dhe në konsultim me përfaqësuesit e qeverisë dhe MCC-së. Dispozitat e përgjithshme në shtojcën 2 të bashkëngjitur, që aplikohen kur fondet i disbursohen Marrësit të grantit nuk do të aplikohen në këtë program, pasi, sipas kësaj marrëveshjeje, asnjë fond i USAID nuk disbursohet për Marrësin e grantit".

USAID-i do të monitorojë performancën sipas këtyre marrëveshjeve, si edhe do të mbikëqyrë performancën e partnerëve zbatues dhe ecurinë në drejtim të arritjes së rezultateve.

USAID-i do t'i japë Drejtorisë së Thesarit të Ministrisë së Financave informacion mbi disbursimet që lidhen me këtë Marrëveshje në një format dhe përmbajtje të rënë dakord nga të dyja Palët.

C. PARTNERËT ZBATUES

USAID-i do të përzgjedhë partnerët zbatues, duke u konsultuar me Marrësin e grantit dhe do të sigurojë që partnerët zbatues të kryejnë zbatimin e programit në përputhje me këtë Marrëveshje dhe t'i raportojnë USAID-it në mënyrë të drejtpërdrejtë. Çdo marrëveshje ndërmjet USAID-it dhe një partneri zbatues që është një organizatë, do të jetë në përputhje me këtë Marrëveshje dhe do të përfshijë një plan monitorimi dhe vlerësimi, duke përfshirë treguesit, synimet dhe rezultatet.

D. MCC-ja

MCC-ja ka ngarkuar USAID-in me përgjegjësinë për administrimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, sipas parimeve të MCC-së për pronësinë kombëtare, përgjegjshmërinë dhe theksimin e rezultateve. MCC-ja nuk do të ketë të drejta ose detyrime sipas kësaj Marrëveshjeje.

VI. PLANI FINANCIAR

Plani financiar "Plani financiar" në lidhje me programin është paraqitur më poshtë. Plani financiar mund të pësojë ndryshime me shkrim nga ana e përfaqësuesve të autorizuar pa amendim formal të Marrëveshjes, nëse këto ndryshime nuk bëjnë që kontributi i USAID-it të tejkalojë shumën e specifikuar në seksionin 3.1 të Marrëveshjes.

Komponenti i programit	Kontributi i USAID-it (në dollarë amerikanë)
A. Gjykatat administrative	$3,044,000
B. Reformat në administratën tatimore	$3,902,000
C. Qendra Kombëtare për Licencimin e Biznesit	$2,994,000
D. Regjistri Kombëtar i Planifikimit	$3,225,000
E. Njësitë e Përbashkëta të Hetimit	$1,616,000
F. Monitorimi nga shoqëria civile e përpjekjeve antikorrupsion të qeverisë	$750,000
G. Monitorimi	$200,000
TOTAL	$15,731,000

VII. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi dhe vlerësimi i programit do të bazohet në faktorë sasiorë dhe cilësorë dhe do të kryhet nga Ministria e Financave me asistencën teknike të siguruar sipas kësaj Marrëveshjeje nga partnerët zbatues dhe USAID-i.

Gjithashtu, qeveria do të monitorojë të gjitha rezultatet për të siguruar që performanca është në përputhje me Marrëveshjen në fjalë.

SHTOJCA 2
DISPOZITAT STANDARDE

Neni A
Përkufizimet dhe dokumentet e zbatimit

Seksioni A.1 Përkufizimet. Siç përdoret në këtë shtojcë "Marrëveshja" i referohet Marrëveshjes së grantit të objektivit strategjik, duke përfshirë shtojcën 1, në të cilën është bashkëngjitur kjo shtojcë dhe pjesë e të cilës është kjo shtojcë. Termat me shkronja kapitale të përdorura dhe që nuk janë përcaktuar ndryshe në këtë shtojcë kanë të njëjtin kuptim ose referencë si në Marrëveshje.

Seksioni A.2 Dokumentet e zbatimit. Për të asistuar Marrësin e grantit në zbatimin e Marrëveshjes, USAID-i, herë pas here, do të japë informacion shtesë në lidhje me çështjet e deklaruara në këtë Marrëveshje. Palët, gjithashtu mund të lëshojnë dokumente zbatimi me pëlqimin e përbashkët, për të konfirmuar dhe treguar mirëkuptimin e tyre të ndërsjellë mbi aspekte të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Dokumentet e zbatimit, gjithashtu mund të lëshohen për të treguar rishikime ose përjashtime, të cilat lejohen nga Marrëveshja.

Neni B
Marrëveshje të përgjithshme

Seksioni B.1 Konsulenca. Palët do të bashkëpunojnë për të siguruar arritjen e objektivit dhe rezultateve të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, Palët, me kërkesën e secilës, do të shkëmbejnë mendime në lidhje me ecurinë drejt objektivit dhe rezultateve, performancën e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, performancën e ndonjë konsulenti, kontraktuesi ose furnizuesi të angazhuar sipas Marrëveshjes dhe çështje të tjera që kanë lidhje me Marrëveshjen.

Seksioni B.2 Ekzekutimi i Marrëveshjes. Marrësi i grantit:

a) Do ta realizojë Marrëveshjen ose nxisë realizimin e saj me kujdesin dhe efikasitetin e duhur dhe konform praktikave të shëndosha teknike, financiare dhe menaxhuese, si dhe në përputhje me ato dokumente, plane, specifikime, kontrata, programe ose rregullime të tjera dhe me ndonjë modifikim në të, miratuar nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) Do të sigurojë menaxhim të kualifikuar dhe me përvojë, si dhe trajnim të personelit si të jetë më e përshtatshme për mbështetjen dhe operimin e veprimtarive të financuara nga Marrëveshja dhe, siç është e zbatueshme për veprimtaritë e vazhdueshme; do të nxisë operimin dhe mbështetjen e atyre veprimtarive, në mënyrë që të sigurojë arritjen e vazhdueshme dhe të suksesshme të objektivit dhe rezultateve të Marrëveshjes.

Seksioni B.3 Shfrytëzimi i mallrave dhe shërbimeve

a) Çdo mall dhe shërbim i financuar nga kjo Marrëveshje, për sa kohë që USAID-i nuk bie dakord ndryshe me shkrim, do t'i kushtohet Marrëveshjes deri në përfundimin ose mbarimin e Marrëveshjes, dhe më pas, (si dhe gjatë ndonjë periudhe pezullimi të Marrëveshjes) do të përdoret për të nxitur objektivin e Marrëveshjes dhe siç mund të urdhërojë USAID-i në dokumentet e zbatimit.

b) Mallrat ose shërbimet e financuara nga kjo Marrëveshje, përveç rasteve kur USAID mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim, nuk do të përdoren për të nxitur ose asistuar një projekt ose veprimtari ndihme të huaj të shoqëruar ose financuar nga një vend që nuk është i përfshirë në kodin gjeografik të USAID-it 935, siç është në fuqi gjatë kohës së këtij përdorimi.

Seksioni B.4 Taksimi

a) Përjashtimi nga detyrimi i përgjithshëm. Marrëveshja dhe asistenca që ajo parashikon janë të përjashtuara nga çdo taksë e vënë sipas ligjeve në fuqi në territorin e Marrësit të grantit.

b) Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë dispozitë, përjashtimi nga detyrimi i përgjithshëm në nënseksionin (a) zbatohet, por nuk është i kufizuar: 1) ndaj çdo veprimtarie, kontrate, granti ose marrëveshje tjetër zbatuese të financuar nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje; 2) çdo transaksioni ose furnizimi, pajisjeje, materialesh, prone ose mallrave të tjera (më poshtë të quajtura së bashku "mallra") sipas pikës (1) më sipër; 3) çdo kontraktuesi, marrësi granti ose organizate tjetër që kryen veprimtari të financuara nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje; 4) çdo punonjësi të këtyre organizatave; dhe 5) çdo kontraktuesi ose marrësi granti individual që kryen veprimtari të financuara nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje.

c) Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë dispozitë, përjashtimi nga detyrimi i përgjithshëm në nënseksionin (a) zbatohet, por nuk është i kufizuar për taksat e mëposhtme:

1) Përjashtimi nga detyrimi 1. Taksat doganore, tarifat, taksat e importit ose taksat e tjera në importimin, përdorimin dhe rieksportimin e mallrave ose sendeve personale (duke përfshirë automobilat që janë pronë private) për përdorim personal të individëve jo vendas ose të anëtarëve të familjeve të tyre. Përjashtimi 1 përfshin, por nuk është i kufizuar për të gjitha tarifat, bazuar në vlerën e atyre mallrave të importuara, por nuk përfshin tarifat e shërbimit të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me shërbimet e kryera për transferimin e mallrave ose ngarkesës së mallrave.

2) Përjashtimi nga detyrimi 2. Taksat mbi të ardhurat, fitimin ose pasurinë e të gjitha: i) organizatave jokombëtare të çdo lloji; ii) punonjësit jovendas të organizatave kombëtare dhe jokombëtare; ose iii) kontraktuesit dhe marrësit e grantit jokombëtarë individualë. Përjashtimi nga detyrimi 2 përfshin të ardhurat dhe taksat e sigurimeve shoqërore të të gjitha llojeve dhe të gjitha taksat mbi pasurinë personale ose të patundshme, të zotëruara nga ato organizata ose persona jovendas. Termi "kombëtar ose shtetas" i referohet organizatave të krijuara sipas ligjeve të marrësit të grantit dhe shtetasve të vendit marrës të grantit, të ndryshëm nga shtetasit e huaj me banim të përhershëm në Shtetet e Bashkuara.

3) Përjashtimi nga detyrimi 3. Taksat e vëna mbi transaksionin e fundit për blerjen e mallrave ose shërbimeve të financuara nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë taksat e shitjeve, tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) ose taksave mbi blerjet ose shumave të qirasë së pasurisë së patundshme ose personale. Termi "transaksion i fundit" i referohet transaksionit të fundit me anë të të cilit mallrat ose shërbimet janë blerë për përdorim në veprimtaritë e financuara nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje.

d) Nëse një taksë është vënë dhe paguar në kundërshtim me dispozitat e një përjashtimi nga një detyrim, USAID-i, brenda fushës së veprimit të tij, mund: 1) të kërkojë që Marrësi i grantit të rimbursojë USAID-in ose të tjerët, kur USAID-i mund të urdhërojë sasinë e kësaj takse me fonde të ndryshme nga ato të siguruara sipas Marrëveshjes; ose 2) të rimbursojë sasinë e kësaj takse nga sasitë

që do të disbursohen sipas kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshje të tjera ndërmjet palëve.

e) Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, në lidhje me aplikimin e një përjashtimi nga detyrimi, Palët bien dakord të takohen menjëherë dhe t'i zgjidhin këto çështje, udhëhequr nga parimi që asistenca e dhënë nga USAID-i është e përjashtuar nga tatimi i drejtpërdrejtë, në mënyrë që e gjithë asistenca e dhënë nga USAID-i të kontribuojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit të Marrësit të grantit.

Seksioni B.5 Raportet dhe informacioni, librat dhe regjistrat e Marrëveshjes, kontrollet financiare dhe inspektimet.

a) Raportet dhe informacioni. Marrësi i grantit do t'i japë USAID-it regjistra llogarie dhe informacion e raporte të tjera të ngjashme në lidhje me Marrëveshjen, siç mund të kërkojë USAID-i në mënyrë të arsyeshme.

b) Librat dhe regjistrat e Marrëveshjes së Marrësit të grantit. Marrësi i grantit do të mbajë libra llogarie, regjistra, dokumente dhe prova të tjera në lidhje me Marrëveshjen, të mjaftueshme për të treguar, pa kufizim, të gjitha kostot e shkaktuara nga Marrësi i grantit sipas Marrëveshjes, marrjen dhe përdorimin e mallrave dhe shërbimeve të përftuara sipas Marrëveshjes nga Marrësi i grantit, kërkesat e ndarjes së kostos të rëna dakord, natyrën dhe shkallën e kërkesave të furnizuesve të mundshëm të mallrave dhe shërbimeve të përftuara nga Marrësi i grantit, bazën financiare të kontratave dhe urdhrave të Marrësit të grantit dhe ecurinë e përgjithshme të Marrëveshjes drejt përfundimit ("Librat dhe regjistrat e Marrëveshjes"). Marrësi i grantit do të mbajë libra dhe regjistra të Marrëveshjes, në përputhje me parimet e kontabilitetit të pranuara gjerësisht që dominojnë në Shtetet e Bashkuara ose me zgjedhjen e Marrësit të grantit, me miratim nga USAID-i, do të mbështesë parime të tjera kontabiliteti, si ato (1) të parashikuara nga Komiteti Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (një degë e Federatës Ndërkombëtare të Llogaritarëve) ose (2) që dominon në vendin e Marrësit të grantit. Librat dhe regjistrat e Marrëveshjes do të mbahen për të paktën tre vjet pas datës së disbursimit të fundit nga USAID-i ose për periudhë më të gjatë, nëse ka, të kërkuar për të zgjidhur ndonjë mosmarrëveshje, pretendim ose zbulim të kontrollit financiar.

c) Kontrolli financiar i Marrësit të grantit. Nëse 300 000 dollarë ose më shumë nga fondet e USAID-it, shpenzohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Marrësi i grantit në vitin e tij fiskal sipas Marrëveshjes, Marrësi i grantit do të kryejë kontrolle financiare të shpenzimeve në përputhje me kushtet e mëposhtme, përveç rasteve kur Palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim.

1. Me miratimin e USAID-it, Marrësi i grantit do të përdorë institucionin e tij më të lartë të kontrollit financiar ose do të përzgjedhë një kontrollor financiar të pavarur, në përputhje me "Udhëzimet për kontrollet financiare të kontraktuara nga marrësit e huaj" lëshuar nga Inspektori i Përgjithshëm i USAID-it (Udhëzimet) dhe kontrollet financiare do të kryhen në përputhje me "Udhëzimet"; dhe

2. Kontrolli financiar do të përcaktojë nëse marrja dhe shpenzimi i fondeve të siguruara sipas Marrëveshjes janë paraqitur në përputhje me parimet e pranuara gjerësisht të kontabilitetit të rëna dakord në seksionin (b) më lart dhe nëse Marrësi i grantit u është përmbajtur kushteve të Marrëveshjes. Çdo kontroll financiar do të përfundojë jo më vonë se nëntë muaj pas mbylljes së vitit të Marrësit të grantit, sipas kontrollit financiar.

d) Kontrollet financiare për nënmarrësit. Marrësi i grantit, përveç rasteve kur Palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim, do t'i dorëzojë USAID-it, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për USAID-in, një plan në lidhje me kontrollin financiar të shpenzimeve të nën-marrësve "të mbuluar", siç përcaktohet më poshtë, që marrin fondet sipas kësaj marrëveshjeje në bazë të një kontrate ose marrëveshjeje të drejtpërdrejtë me Marrësin e grantit.

1. Një nënmarrës "i mbuluar" është ai që shpenzon 300 000 ose më shumë dollarë në vitin e tij fiskal të "financave të USAID-it (d.m.th., si marrës të kontratave të rimbursueshme të kostos, granteve ose marrëveshjeve të bashkëpunimit të USAID-it dhe si nënmarrës sipas objektivit strategjik të USAID-it të marrëveshjeve të tjera të grantit me qeveritë e huaja).

2. Plani do të përshkruajë metodologjinë që do të përdoret nga Marrësi i grantit për të përmbushur përgjegjësitë e tij të kontrollit financiar për nënmarrësit e mbuluar. Marrësi i grantit mund t'i përmbushë këto përgjegjësi kontrolli financiar duke u mbështetur në kontrollet e pavarura financiare të nënmarrësve; duke zgjeruar fushën e veprimtarisë së kontrollit të pavarur financiar të Marrësit të grantit, për të përfshirë testimin e llogarive të nënmarrësve, ose një kombinim të këtyre procedurave.

3. Plani do të identifikojë fondet në dispozicion të nënmarrësve të mbuluar që do të mbulohen nga kontrollet financiare të kryera në përputhje me kushtet e kontrolleve të tjera financiare, të cilat do të përmbushnin përgjegjësitë e kontrollit financiar të Marrësit të grantit. (Një organizate jofitimprurëse e organizuar në Shtetet e Bashkuara i kërkohet të marrë masat për kontrollet e saj financiare. Një kontraktuesi fitimprurës i organizuar në Shtetet e Bashkuara që ka kontratë të drejtpërdrejtë me USAID-in i bëhet kontroll financiar nga Agjencia përgjegjëse e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Një organizate private vullnetare e organizuar jashtë Shteteve të Bashkuara me një grant të drejtpërdrejtë nga USAID-i i kërkohet të marrë masat për kontrollet e saj financiare. Një kontraktues i vendit pritës duhet të auditohet nga agjencia e kontrollit financiar të Marrësit të grantit.).

4. Marrësi i grantit do të sigurojë që nënmarrësit e mbuluar sipas kontratave ose marrëveshjeve të drejtpërdrejta me Marrësin e grantit të marrin masa përmirësuese të përshtatshme dhe në kohë; të marrë në konsideratë nëse kontrollet financiare të nënmarrësve kanë nevojë për rregullime të të dhënave të tyre; dhe nëse secili nënmarrës duhet të lejojë kontrollorë të pavarur financiarë që të kenë akses tek të dhënat dhe deklaratat financiare, sipas nevojës.

e) Raportet e kontrolleve financiare. Marrësi i grantit do t'i japë ose do të nxisë dhënien ndaj USAID-it të një raporti kontrolli financiar në lidhje me çdo kontroll financiar të organizuar nga Marrësi i grantit, në përputhje me këtë seksion brenda 30 ditëve pas përfundimit të kontrollit financiar dhe jo më vonë se nëntë muaj pas përfundimit të periudhës së kontrollit financiar.

f) Nënmarrësit e tjerë të mbuluar. Për nënmarrësit "e mbuluar" të cilët marrin fonde sipas Marrëveshjes në bazë të kontratave ose marrëveshjeve të drejtpërdrejta me USAIDI-in, USAID-in do të përfshijë kërkesa të përshtatshme kontrolli financiar në ato kontrata ose marrëveshje dhe në emër të Marrësit të grantit do të kryejë veprimtaritë përkatëse në lidhje me raportet e kontrollit financiar, të dhëna sipas këtyre kërkesave.

g) Kostoja e kontrolleve financiare. Objekt i miratimit me shkrim nga USAID-i, kostot e kontrolleve financiare të kryera në përputhje me kushtet e këtij seksioni, mund t'i ngarkohen Marrëveshjes.

h) Kontrolli financiar nga USAID-i. USAID-i ka të drejtën të kryejë kontrolle financiare që kërkohen sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Marrësit të grantit, duke përdorur fondet sipas Marrëveshjes ose burime të tjera në dispozicion të USAID-it për këtë qëllim, të kryejë rishikim financiar ose ndryshe të sigurojë përgjegjshmërinë e organizatave që shpenzojnë fondet e USAID-it, pavarësisht nga kërkesa e kontrollit financiar.

i) Mundësia për kontroll financiar ose inspektim. Marrësi i grantit do t'u sigurojë përfaqësuesve të autorizuar të USAID-it mundësinë, në të gjitha periudhat e arsyeshme, të kryejnë kontrolle financiare ose të inspektojnë veprimtari të financuara sipas Marrëveshjes, përdorimin e mallrave dhe shërbimeve të financuara nga USAID-i si edhe libra, regjistra e dokumente të tjera në lidhje me Marrëveshjen.

j) Librat dhe regjistrat e nënmarrësve. Marrësi i grantit do të përfshijë paragrafët (a), (b), (d), (e), (g), (h) dhe (i) të kësaj dispozite në të gjitha nënmarrëveshjet me organizatat joamerikane, të cilat plotësojnë vlerën fillestare prej 300 000 $ të paragrafit (c) të kësaj dispozite. Nënmarrëveshjet me organizatat joamerikane, të cilat nuk e plotësojnë vlerën fillestare prej 300 000 $, duhet, minimalisht, të përfshijnë paragrafët (h) dhe (i) të kësaj dispozite. Nënmarrëveshjet me organizatat amerikane do të deklarojnë se organizata amerikane është objekt i kërkesave të kontrollit financiar në përmbajtje të qarkores OMB A-133.

Seksioni B.6 Plotësimi i informacionit. Marrësi i grantit konfirmon:

a) që faktet dhe rrethanat për të cilat është informuar USAID-i ose kanë bërë që USAID-i të informohet gjatë arritjes së marrëveshjes me USAID-in në lidhje me Marrëveshjen, janë të sakta dhe të plota dhe përfshijnë të gjitha faktet dhe rrethanat që mund të cenojnë materialisht Marrëveshjen dhe përmbushjen e përgjegjësive sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) që do të informojë USAID-in në mënyrë koherente në lidhje me faktet dhe rrethanat e mëtejshme që mund të cenojnë materialisht ose që ka arsye të besohet se mund të cenojnë Marrëveshjen ose përmbushjen e përgjegjësive sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni B.7 Pagesa të tjera. Marrësi i grantit konfirmon që asnjë pagesë nuk është marrë ose nuk do të merret nga ndonjë zyrtar i Marrësit të grantit në lidhje me prokurimin e mallrave ose

shërbimeve të financuara sipas Marrëveshjes, përveç tarifave, taksave ose pagesave të ngjashme të vendosura ligjërisht në vendin e Marrësit të grantit.

Seksioni B.8 Informacioni dhe markimi. Marrësi i grantit do t'i japë publicitetin e duhur Marrëveshjes si një program për të cilin Shtetet e Bashkuara kanë kontribuar, do të identifikojë vendet e veprimtarive të Marrëveshjes dhe do të markojë mallrat e financuara nga USAID-i, siç janë përshkruar në dokumentet e zbatimit.

Neni C

Dispozitat e prokurimit

Seksioni C.1 Burimi dhe origjina

a) Disbursimet sipas kësaj Marrëveshjeje do të përdoren ekskluzivisht për të financuar kostot e mallrave dhe shërbimeve që kërkon të ketë Marrëveshja, në lidhje me mallrat, burimin dhe origjinën e tyre dhe në lidhje me furnizuesit e mallrave dhe shërbimeve, kombësinë e tyre, në vendet e përfshira në kodin gjeografik 935 siç janë në fuqi në kohën që janë bërë porositë ose kontratat për ato mallra ose shërbime, përveç rasteve kur USAID-i mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim dhe si më poshtë:

1. Kostot e transporteve oqeanike do të financohen sipas Marrëveshjes vetëm për anije nën regjistrin e flamurëve të vendeve të përfshira në kodin gjeografik 935. Gjithashtu, shih seksionin C.6 në lidhje me përdorimin e anijeve me flamur amerikan.

2. Vendi i Marrësit të grantit është një burim i mundshëm për sigurimin detar.

b) Burimi dhe origjina e transporteve oqeanike dhe ajrore do të konsiderohet të jetë vendi i regjistrimit në kohën e ngarkesës të anijes oqeanike ose avionit.

c) Dispozitat në lidhje me mallrat dhe shërbimet e kufizuara dhe të papranueshme mund të sigurohen në një dokument zbatimi.

d) Transporti ajror i pasurisë ose personave të financuar sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë me mjetet e transportit që mbajnë vërtetimin e Shteteve të Bashkuara, në masën që shërbimi nga këto mjete transporti të jetë në dispozicion sipas aktit amerikan të fluturimit. Kjo kërkesë mund të përshkruhet më tej nga USAID-i në dokumentet e zbatimit.

Seksioni C.2 Data e pranimit. Asnjë mall ose shërbim që nuk është prokuruar sipas urdhrave ose kontratave të vendosura ose lidhura në formë të prerë para datës së kësaj Marrëveshjeje, përveçse kur Palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim, nuk mund të financohet sipas Marrëveshjes.

Seksioni C.3 Planet, specifikimet dhe kontratat. Me qëllim që të ketë marrëveshje të ndërsjellë për çështjet e mëposhtme dhe përveç rasteve kur Palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim:

a) Marrësi i grantit do t'i japë USAID-it të përgatitur:

1) Çdo plan, specifikim, prokurim ose program ndërtimi, kontratë ose dokumentacion tjetër ndërmjet Marrësit të grantit dhe palëve të treta, në lidhje me mallrat ose shërbimet që do financohen sipas Marrëveshjes, duke përfshirë dokumentacionin në lidhje me parakualifikimin dhe përzgjedhjen e kontraktuesve dhe kërkesën e ofertave dhe propozimeve. Modifikime materiale në këtë dokumentacion do t'i jepen USAID-it gjithashtu të përgatitura; dhe

2) Ky dokumentacion do t'i jepet USAID-it, i përgatitur edhe në lidhje me mallra ose shërbime, të cilat megjithëse jo të financuara sipas Marrëveshjes, konsiderohen nga USAID-i të një rëndësie të veçantë për Marrëveshjen. Aspektet e Marrëveshjes, duke përfshirë çështje sipas këtij nënseksioni (a) (2) do të identifikohen në dokumentet e zbatimit.

b) Dokumentet në lidhje me parakualifikimin e kontraktuesve dhe kërkesën e ofertave ose propozimeve për mallra dhe shërbime të financuara sipas Marrëveshjes, do të miratohen nga USAID-i me shkrim para lëshimit të tyre dhe kushtet e tyre do të përfshijnë standardet dhe treguesit e Shteteve të Bashkuara;

c) Kontratat dhe kontraktuesit e financuar sipas Marrëveshjes për shërbime inxhinierie dhe shërbime të tjera profesionale, për shërbime ndërtimi dhe për shërbime të tjera të ngjashme, pajisje ose materiale siç mund të specifikohen në dokumentet e zbatimit, do të miratohen nga USAID-i me shkrim para ekzekutimit të kontratës. Modifikimet në materiale në ato kontrata do të miratohen me shkrim nga USAID-i para ekzekutimit; dhe

d) Firmat konsulente nga Marrësi i grantit për Marrëveshjen, por jo të financuara sipas Marrëveshjes, fusha e veprimit të shërbimeve të tyre dhe ajo e personelit të tyre të caktuar për

veprimtaritë e financuara sipas Marrëveshjes, siç mund ta specifikojë USAID-i; dhe kontraktuesit e ndërtimit të përdorur nga Marrësi i grantit për Marrëveshjen, por jo të financuar nga Marrëveshja, do të jenë të pranueshëm nga USAID-i.

Seksioni C.4 Çmimi i arsyeshëm. Vetëm çmimet e arsyeshme do të paguhen për çdo mall ose shërbim të financuar, tërësisht ose pjesërisht nga Marrëveshja. Këta artikuj do të prokurohen në mënyrë të ndershme dhe në një shkallë maksimalisht praktike dhe mbi baza konkurruese.

Seksioni C.5 Njoftimi i furnizuesve të mundshëm. Për të lejuar të gjitha firmat e Shteteve të Bashkuara të kenë mundësinë të marrin pjesë në furnizimin e mallrave dhe shërbimeve që do të financohen sipas Marrëveshjes, Marrësi i grantit do t'i japë USAID-it këtë informacion në lidhje me të dhe në kohën kur USAID-i mund ta kërkojë, në dokumentet e zbatimit.

Seksioni C.6 Dërgesat/transporti

a) Përveç kërkesave në seksionin C.1 (a), kostot e transportit oqeanik ose ajror dhe shërbime të ngjashme dërgimi mund të mos financohen nga granti, nëse kostot janë për transportin me një anije oqeanike ose avion me qira, që nuk kanë marrë miratimin paraprak të USAID-it.

b) Nëse USAID-i nuk vendos që anijet oqeanike tregtare private me flamurin e Shteteve të Bashkuara nuk janë në dispozicion me çmime të drejta dhe të arsyeshme për ato anije, ose bie dakord ndryshe me shkrim:

1. të paktën pesëdhjetë për qind (50%) e tonazhit bruto të të gjitha mallrave (të llogaritura veçmas për mjetet e transportit në masë për mallrat e ngurta, anije ngarkese për mallra të ngurta dhe anijet cisternë) të financuara nga USAID-i që mund të transportohen me anije oqeanike, do të transportohet me anije tregtare private me flamurin e Shteteve të Bashkuara; dhe

2. të paktën pesëdhjetë për qind (50%) e të ardhurave bruto të ngarkesës së mallrave të nxjerra nga të gjitha ngarkesat e financuara nga USAID-i dhe të transportuara në territorin e Marrësit të grantit në anije ngarkese për mallra të ngurta do të paguhen për ose në interes të anijeve tregtare private që mbajnë flamurin e Shteteve të Bashkuara. Përputhshmëria me kërkesat e (1) dhe (2) të këtij nënseksioni duhet të arrihet në lidhje me çdo ngarkesë të transportuar nga portet e Shteteve të Bashkuara dhe çdo ngarkesë të transportuar nga portet jo amerikane, llogaritur më vete.

Seksioni C.7 Sigurimet

a) Sigurimet detare për mallrat e financuara nga USAID-i që duhet të transportohen për në territorin e Marrësit të grantit mund të financohen nga kjo Marrëveshje me kusht që: 1) këto sigurime të jenë vendosur në tarifën më të favorshme dhe konkurruese të mundshme; 2) këto sigurime të jenë vendosur në një vend që është autorizuar sipas seksionit C.1 (a); dhe 3) tarifat më poshtë janë të pagueshme në dollarë amerikanë ose në ndonjë valutë lirisht të konvertueshme, nëse USAID-i nuk bie dakord ndryshe me shkrim.

Nëse Marrësi i grantit (ose qeveria e Marrësit të grantit), me statut, dekret, rregull, rregullore ose praktikë bën dallime në lidhje me prokurimin e financuar nga USAID-i kundër çdo kompanie sigurimesh detare të autorizuar të bëjë biznes në çdo shtet të Shteteve të Bashkuara, atëherë të gjitha mallrat e ngarkuara për në territorin e Marrësit të grantit të financuar nga USAID-i më poshtë, do të sigurohen kundër rreziqeve detare dhe çdo sigurim do të vendoset në Shtetet e Bashkuara me një kompani ose kompani të autorizuara për të bërë biznes sigurimi detar në Shtetet e Bashkuara.

b) Përveç rasteve kur USAID mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim, Marrësi i grantit do të sigurojë ose do të nxisë sigurimin e mallrave të financuara nga Marrëveshja të importuara për Marrëveshjen kundër rreziqeve të mundshme për tranzitin e tyre në pikën e përdorimit të tyre sipas Marrëveshjes; atëherë këto sigurime do të lëshohen në bazë të kushteve në përputhje me praktikën e shëndoshë tregtare dhe do të sigurojnë vlerën e plotë të mallrave. Çdo zhdëmtim i marrë nga Marrësi i grantit sipas këtij sigurimi do të përdoret për të zëvendësuar ose riparuar çdo dëm material ose humbje të mallrave të siguruara ose do të përdoret për të rimbursuar Marrësin e grantit për zëvendësimin ose riparimin e këtyre mallrave. Çdo zëvendësim i tillë do të ketë burimin dhe origjinën e vendeve të listuara në kodin gjeografik të USAID-it 935 siç është në fuqi në kohën e zëvendësimit dhe, përveç rasteve kur Palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim, do të jetë objekt i dispozitave të Marrëveshjes.

Seksioni C.8 Pronësia e tepërt që i përket qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Marrësi i grantit

bie dakord që, kudo që të jetë e zbatueshme, pronësia personale e tepërt që i përket qeverisë së Shteteve të Bashkuara, në vend të artikujve të rinj të financuar nga granti, duhet të përdoret. Sipas Marrëveshjes, fondet mund të përdoren për të financuar kostot e përftimit të kësaj pasurie.

Neni D
Të ndryshme

Seksioni D.1 Disbursimet. Asnjë disbursim ndaj Marrësit të grantit nuk do të shqyrtohet sipas kësaj Marrëveshjeje. Nëse kërkohen disbursime për Marrësin e grantit, disbursimet do të bëhen nëpërmjet atyre mënyrave që Palët bien dakord me shkrim ose siç parashtrohet në shtojcën 1.

Seksioni D.2 Kursi i këmbimit. Nëse fondet e siguruara sipas Marrëveshjes paraqiten në territorin e Marrësit të grantit nga USAID-i ose çdo agjenci publike ose private për qëllime të kryerjes së detyrimeve të USAID-it si më poshtë, Marrësi i grantit do të bëjë këto rregullime sipas nevojës, në mënyrë që këto fonde të mund të konvertohen në monedhën lokale në kursin e këmbimit më të lartë të mundshëm, i cili në kohën që është bërë këmbimi, është i ligjshëm në vendin e Marrësit të grantit për çdo person dhe për çdo qëllim.

Neni E
Mbarimi, zgjidhjet ligjore

Seksioni E.1 Pezullimi dhe përfundimi

a) Çdo Palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në tërësinë e saj duke i dhënë Palës tjetër një njoftim me shkrim 30 ditë para. USAID-i gjithashtu mund ta përfundojë këtë Marrëveshje pjesërisht duke i dhënë Marrësit të grantit një njoftim me shkrim mbi bazën e 30 ditëve dhe ta pezullojë këtë Marrëveshje tërësisht ose pjesërisht, duke i dhënë Marrësit të grantit një njoftim me shkrim. Për më tepër, USAID-i mund ta përfundojë këtë Marrëveshje tërësisht ose pjesërisht duke i dhënë Marrësit të grantit njoftim me shkrim, nëse: i) Marrësi i grantit nuk arrin t'i përmbahet ndonjë dispozite të Marrëveshjes; ii) ndodh diçka që USAID-i vendos se e bën të pamundur arritjen e objektivit ose rezultateve të Marrëveshjes ose programit të asistencës apo që Marrësi i grantit do të jetë në gjendje të kryejë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose iii) çdo disbursim ose përdorim i fondeve në mënyrën e shqyrtuar këtu do të ishte në shkelje të legjislacionit në lidhje me USAID-in ose grantin, qoftë për periudhën aktuale ose më pas në fuqi.

b) Përveç pagesës, të cilën Palët janë të përkushtuara ta bëjnë sipas angazhimeve të parevokueshme të bëra me palët e treta para këtij pezullimi ose përfundimi, pezullimi ose përfundimi i gjithë kësaj Marrëveshjeje ose pjesërisht i saj do të pezullojë (për periudhën e pezullimit) ose përfundojë, si të jetë e zbatueshme, çdo detyrim të Palëve për të siguruar burime financiare ose burime të tjera për Marrëveshjen ose për pjesën e pezulluar apo të përfunduar të Marrëveshjes, si të jetë e zbatueshme. Çdo pjesë e kësaj Marrëveshjeje, e cila nuk është pezulluar ose përfunduar, do të mbesë në fuqi të plotë.

c) Për më tepër, pas këtij pezullimi ose përfundimi të plotë ose të pjesshëm, USAID-i, me shpenzimet e USAID-it, mund të urdhërojë që e drejta për mallrat e financuara sipas Marrëveshjes ose sipas pjesës së zbatueshme të Marrëveshjes, të transferohet te USAID-i nëse mallrat janë në gjendje të dërgohen.

Seksioni E.2 Rimbursimet

a) Në rast të ndonjë disbursimi i cili nuk është mbështetur me dokumentacion të vlefshëm në përputhje me këtë Marrëveshje ose që nuk është bërë ose përdorur në përputhje me këtë Marrëveshje ose ka qenë për mallra apo shërbime që nuk janë përdorur në përputhje me këtë Marrëveshje, USAID-i, me gjithë disponueshmërinë ose ushtrimin e çdo zgjidhjeje tjetër ligjore sipas kësaj Marrëveshjeje, mund të kërkojë që Marrësi i grantit të rimbursojë shumën e këtij disbursimi në dollarë amerikanë ndaj USAID-it brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas marrjes së një kërkese në lidhje me të.

b) Nëse pamundësia e Marrësit të grantit të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje çon në rezultatin që mallrat ose shërbimet e financuara ose të mbështetura sipas Marrëveshjes nuk përdoren efektivisht në përputhje me këtë Marrëveshje, USAID-i mund të kërkojë që Marrësi i grantit të rimbursojë të gjithën ose një pjesë të sasisë së disbursimeve sipas kësaj Marrëveshjeje për ose në lidhje me këto mallra apo shërbime në dollarë amerikanë ndaj USAID-it

brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas marrjes së një kërkese në lidhje me të.

c) E drejta sipas nënseksioneve (a) ose (b) për të kërkuar një kompensim disbursimi do të vazhdojë, pavarësisht ndonjë dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje, për një periudhë tre vjeçare pas datës së disbursimit të fundit sipas kësaj Marrëveshjeje.

d) (1) Çdo rimbursim sipas nënseksioneve (a) ose (b), ose (2) çdo rimbursim ndaj USAID-it nga një kontraktues, furnizues, bankë ose palë tjetër e tretë në lidhje me mallrat ose shërbimet e financuara nga Marrëveshja, që ka lidhje me një çmim të paarsyeshëm ose faturim të gabuar të mallrave, ose shërbimeve ose për mallrat që nuk kanë qenë në përputhje me specifikimet apo me shërbimet që ishin të pamjaftueshme, do të (A) vihen së pari në dispozicion të Marrëveshjes, në sasinë e justifikuar, dhe (B) pjesa që mbetet, nëse ka, do të zbatohet për të ulur shumën e grantit.

e) Çdo interes ose e ardhur tjetër mbi fondet e disbursuara nga USAID-i ndaj Marrësit të grantit sipas kësaj Marrëveshjeje, para përdorimit të autorizuar të këtyre fondeve për Marrëveshjen, do t'i kthehet USAID-it në dollarë amerikanë nga Marrësi i grantit, për sa kohë që USAID nuk bie dakord ndryshe me shkrim.

Seksioni E.3 Mosheqja dorë nga zgjidhjet ligjore. Asnjë vonesë në ushtrimin e ndonjë të drejte ose zgjidhje ligjore që rrjedh për një Palë në lidhje me financimin e saj sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohet si një heqje dorë ndaj kësaj të drejte ose zgjidhjeje ligjore.

Seksioni E.4 Delegimi. Marrësi i grantit bie dakord sipas kërkesës, të ekzekutojë një delegim ndaj USAID-it të veprimi që mund të lindë ndaj Marrësit të grantit në lidhje me ose që rrjedh nga detyrimi kontraktor apo shkelja e performancës nga një palë ndaj një kontrate të drejtpërdrejtë në dollarë amerikanë, që USAID-i ka financuar tërësisht ose pjesërisht nga fondet e dhëna nga USAID-i, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni F
Të ndryshme

Seksioni F.1 Nxitja e investimeve

a) Përveçse kur parashtrohet specifikisht në Marrëveshje ose kur USAID-i autorizon ndryshe me shkrim, asnjë fond ose mbështetje tjetër më poshtë nuk mund të përdoret për ndonjë veprimtari që përfshin nxitjen e investimeve në një vend të huaj.

b) Në rastet kur Marrësit të grantit i kërkohet ose dëshiron të sigurojë asistencë në fushën e mësipërme ose kërkon shpjegim nga USAID-i nëse aktiviteti do të ishte në përputhje me kufizimin e parashtruar më sipër, Marrësi i grantit duhet të njoftojë USAID-in dhe të sigurojë një përshkrim të detajuar të veprimtarisë së propozuar. Marrësi i grantit nuk duhet të procedojë me veprimtarinë derisa të këshillohet nga USAID-i për ta bërë këtë.

c) Marrësi i grantit duhet të sigurojë që punonjësit e tij dhe nënkontraktuesit dhe nënmarrësit që sigurojnë shërbime nxitje investimesh si më poshtë, të jenë në dijeni të kufizimeve të parashtruara në këtë klauzolë dhe duhet ta përfshijnë këtë klauzolë në të gjitha nënkontratat dhe nën marrëveshjet e tjera që janë bërë më poshtë.

Seksioni F.2 Planifikimi familjar vullnetar. Palët bien dakord që të gjitha fondet e USAID-it, të siguruara sipas kësaj marrëveshjeje, do të përdoren në përputhje me politikën e zbatueshme të Shteteve të Bashkuara dhe kërkesat e parashikuara me status në lidhje me projektet e planifikimit familjar vullnetar dhe që asnjë nga fondet e USAID-it të siguruara sipas kësaj Marrëveshjeje apo mallrat apo shërbimet e financuara nga këto fonde, nuk mund të përdoret për

a) kryerjen e abortit si një metodë të planifikimit familjar ose për të motivuar apo shtrënguar ndonjë person të praktikojë aborte;

b) kryerjen e sterilizimeve të pavullnetshme si një metodë të planifikimit familjar ose të shtrëngojë apo sigurojë çdo stimul financiar ndaj çdo personi për të bërë sterilizime; ose

c) çdo kërkim biomjekësor që ka lidhje, tërësisht ose pjesërisht, me metodat ose kryerjen e aborteve apo sterilizimeve të pavullnetshme si një metodë planifikimi familjar.

USAID-i do të përgatisë dokumente zbatimi që përshkruajnë në mënyrë më të plotë kërkesat e këtij seksioni.

Seksioni F.3 Ndalimi mbi asistencën ndaj trafikantëve të drogës. USAID-i rezervon të drejtën ta përfundojë këtë Marrëveshje ose të marrë masa të tjera të përshtatshme nëse Marrësi i grantit ose një individ kryesor i grantit rezulton të jetë i dënuar për një vepër penale në lidhje me lëndët narkotike ose që është përfshirë në trafikun e drogës, siç përcaktohet në 22 Kodin e Rregulloreve Federale

(CFR) Pjesa 140.

Seksioni F.4 Të drejtat e punëtorëve

a) Përveçse kur parashikohet specifikisht në marrëveshje ose kur USAID-i autorizon ndryshe me shkrim, asnjë fond ose mbështetje tjetër e siguruar si më poshtë nuk mund të përdoret për ndonjë veprimtari që përfshin të drejtat e punëtorëve në një vend të huaj.

b) Në rastet kur Marrësit të grantit i kërkohet ose dëshiron të sigurojë asistencë në fushën e mësipërme ose kërkon shpjegim nga USAID-i, nëse veprimtaria do të ishte në përputhje me kufizimin e parashtruar më sipër, Marrësi i grantit duhet të njoftojë USAID-in dhe të sigurojë një përshkrim të detajuar të veprimtarisë së propozuar. Marrësi i grantit nuk duhet të procedojë me veprimtarinë derisa të këshillohet nga USAID-i për ta bërë këtë.

c) Marrësi i grantit duhet të sigurojë që punonjësit e tij dhe nënkontraktuesit dhe nën-marrësit që sigurojnë shërbime në lidhje me punësimin si më poshtë, të jenë në dijeni të kufizimeve të parashikuara në këtë klauzolë dhe duhet ta përfshijnë këtë klauzolë në të gjitha nënkontratat dhe nënmarrëveshjet e tjera që janë bërë më poshtë.

VENDIM
Nr.1593, datë 3.12.2008

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË, PËR KONVERTIMIN E LEJEVE TË DREJTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për konvertimin e lejeve të drejtimit.

Ky vendimit hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË NË LIDHJE ME KONVERTIMIN E LEJEVE TË DREJTIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Italisë, në vijim të quajtura Palë Kontraktuese;

- *me dëshirën* të lehtësojnë qarkullimin e qytetarëve të tyre përkatës në territoret e të dy vendeve dhe të përmirësojnë sigurinë rrugore;
- *të vendosur* të promovojnë bashkëpunimin në sektorin e transportit dhe qarkullimit rrugor;
- *të bindur* për nevojën e avantazheve reciproke të prezantuara nga një marrëveshje mbi konvertimin e lejes së drejtimit;

bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Palët Kontraktuese njohin në mënyrë të ndërsjellë, me qëllim konvertimin, lejet e drejtimit jo të përkohshme dhe brenda afateve të vlefshmërisë, që janë lëshuar nga autoritetet kompetente të Palës

tjetër Kontraktuese, sipas kuadrit të tyre të brendshëm ligjor, në favor të titullarëve të lejeve të drejtimit që marrin rezidencën në territorin e tyre.

Neni 2

Leja e drejtimit e lëshuar nga autoritetet e një prej Palëve Kontraktuese, pushon së qenuri e vlefshme për qëllim qarkullimi në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, pas një viti nga data e marrjes së rezidencës së titullarit të saj në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 3

Në interpretim të neneve të kësaj marrëveshjeje, nënkuptohet me "rezidencë" sa është përcaktuar e rregulluar nga kuadri përkatës ligjor në fuqi pranë Palëve Kontraktuese.

Neni 4

Nëse titullari i lejes së drejtimit të lëshuar nga autoriteti i një prej dy Palëve Kontraktuese vendos rezidencën në territorin e Palës tjetër, e konverton lejen e tij të drejtimit pa iu dashur të japë provime teorike dhe praktike, me përjashtim të rrethanave të veçanta dhe në respektim të sa është parashikuar në paragrafin e mëposhtëm.

Titullari i lejes shqiptare të drejtimit, që është rezident në Itali prej më shumë se katër vjetësh, e konverton dokumentin e tij vetëm nëse u nënshtrohet provimeve të rishikimit të lejes së drejtimit për shkak se është vërtetuar që nuk ka drejtuar automjete për një periudhë trevjeçare.

Autoritetet kompetente mund të kërkojnë një certifikatë mjekësore, e cila vërteton zotërimin e cilësive psikofizike, të nevojshme për kategoritë e kërkuara.

Për zbatimin e paragrafit të parë të këtij neni, titullari i lejes së drejtimit duhet të ketë mbushur moshën e parashikuar nga legjislacionet përkatëse të brendshme për lëshimin e kategorisë për të cilën kërkon konvertimin.

Kufizimet në drejtim automjeti dhe sanksionet, që sipas rastit mund të jenë parashikuar në lidhje me datën e lëshimit të lejes së drejtimit nga legjislacionet e brendshme të dy Palëve Kontraktuese, zbatohen duke iu referuar datës së lëshimit të lejes së parë të drejtimit për të cilën kërkohet konvertimi.

Neni 5

Dispozita e parashikuar në nenin 4, paragrafi i parë, gjen zbatim vetëm për lejet për drejtim automjeti të lëshuara përpara marrjes së rezidencës nga ana e titullarit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe, në rast se janë lëshuar me vlefshmëri të përkohshme, gjen zbatim vetëm për ato që janë bërë të vlefshme në mënyrë të përhershme përpara marrjes së rezidencës së lartpërmendur.

Gjithashtu, neni 4 i mësipërm nuk gjen zbatim për ato leje drejtimi që nga ana e tyre janë marrë në zëvendësim të një dokumenti të lëshuar nga një tjetër shtet dhe që nuk mund të konvertohet në territorin e Palës Kontraktuese që duhet të procedojë me konvertimin.

Për periudhën prej një viti pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, lejohet konvertimi në Itali i lejeve shqiptare të drejtmit të hartuara sipas modelit me karton në fuqi që nga 1 nëntori 1999. Për këto leje drejtimi është e nevojshme të merret gjithmonë *certifikatë e vërtetësisë dhe vlefshmërisë*, parashikuar nga neni 8 pasardhës, paragrafi i dytë.

Neni 6

Në kohën e konvertimit të lejeve të drejtimit, barazvlefshmëria e kategorive të lejeve të drejtimit të Palëve Kontraktuese njihet në bazë të tabelave teknike të barazvlefshmërisë, që i bashkëngjiten kësaj Marrëveshjeje, pjesë përbërëse të të cilës ato janë. Këto tabela, lista e modeleve të lejeve të drejtimit, së bashku me modelet e certifikatës së vërtetësisë dhe vlefshmërisë dhe të vërtetimeve, të përmbajtura në nenin 8, përbëjnë bashkëlidhjet teknike që mund të ndryshohen nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese me një shkëmbim notash verbale.

Autoritetet qendrore kompetente për konvertimin e lejeve të drejtimit janë si vijon:

a) në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit - Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (Rruga "Irfan Tomini" — Tiranë- Shqipëri);

b) në Republikën e Italisë, Ministria e Infrastrukturave dhe Transporteve - Departamenti për Transportin Tokësor dhe për Transportin e Kombinuar- (Via Caraci n.36 — 00157 Roma).

Neni 7

Gjatë procedurave të konvertimit të lejeve të drejtimit, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese tërheqin lejet që duhen konvertuar dhe ua kthejnë ato autoriteteve kompetente të Palës tjetër Kontraktuese, bashkë me një listë të tyre dhe me komunikime në gjuhën italiane.

Neni 8

Autoriteti kompetent i çdonjërës prej Palëve Kontraktuese që kryen konvertimin, kërkon përkthimin zyrtar të lejes së drejtimit. Po ky autoritet, mund t'u kërkojë informacione autoriteteve kompetente të Palës tjetër kontraktuese, në rastet kur lindin dyshime në lidhje me vlefshmërinë, vërtetësinë e lejes së drejtimit dhe të dhënave të treguara në të. Komunikimi do të bëhet në gjuhën italiane. Për shkëmbimin e informacionit, do të përdoren modelet e vërtetimeve bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje.

Autoriteti kompetent italian që kryen konvertimin e lejes së drejtimit shqiptare mund të kërkojë, në shtesë të dokumentit të zakonshëm dhe për të dyja modelet e lejes së drejtimit, një *certifikatë të vlefshmërisë dhe vërtetësisë* të së njëjtës leje drejtimi, lëshuar nga autoriteti kompetent shqiptar.

Kjo certifikatë do të përpilohet në gjuhën italiane, sipas modelit bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje, dhe përmban fotokopjen dhe përkthimin e lejes së drejtimit për konvertim, si dhe deklaron vlefshmërinë, vërtetësinë, datën dhe modalitetin e marrjes së këtij dokumenti.

Neni 9

Autoriteti qendror kompetent i Palës Kontraktuese që merr lejen e drejtimit të tërhequr, pas konvertimit, njofton Palën tjetër nëse dokumenti paraqet parregullsi në lidhje me vlefshmërinë, vërtetësinë dhe të dhënat e treguara në të, me komunikim në gjuhën italiane.

Neni 10

Kjo Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Italisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, së bashku me bashkëlidhjet teknike, që formojnë pjesë përbërëse të saj, do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës së marrjes së të dytit nga dy njoftimet, me të cilat Palët Kontraktuese do t'i njoftojnë njëra-tjetrës përmbushjen e procedurave të parashikuara nga legjislacionet përkatëse.

Kjo Marrëveshje, e cila do të mund të ndryshohet me shkrim me pëlqim të ndërsjellë, do të ketë një kohëzgjatje prej pesë vjetësh dhe do mund të kundërshtohet me shkrim në çdo kohë nga njëra prej Palëve Kontraktuese, ndërkohë që efektet e saj do të pushojnë së qenuri gjashtë muaj pas marrjes së kundërshtimit të bërë.

Në mirëbesim të sa më sipër Përfaqësuesit nënshkrues, të autorizuar nga Qeveritë përkatëse kanë firmosur këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje origjinale, në Tiranë, më 27.10.2008 në gjuhën shqipe dhe italiane, të dy tekstet të bëra me besueshmëri të njëjtë.

I. TABELA E BARAZVLEFSHMËRISË

për konvertimin e lejeve të drejtimit të lëshuara në Shqipëri në dokumenta italiane

SHQIPËRI	ITALI
A	A
B	B
C	C
D	C+D
E	E

II. TABELA E BARAZVLEFSHMËRISË

për konvertimin e lejeve te drejtimit të lëshuara në Itali në dokumenta shqiptare

ITALI	SHQIPËRI
A I	- -
A	A
B (marrë përpara dt.01/01/1986)*	A-B
B (marrë nga dt.01/01/1986 e më tej)*	B
C	C
C+D	D

Leja e drejtimit e kategorisë B italiane aftëson edhe drejtimin e motoçikletave, pa kufizime, nëse është marrë (me provim)o me konvertim) brenda datës 01/01/1986.

NËNKATEGORI TË MUNDSHME TË LËSHUARA NË ITALI NGA DATA 01/01/1996 DERI NË HYRJEN NË FUQI TË DEKRETIT MINISTROR 29/03/1999

B1	--
C1	B
D1	B

MODELE TË LEJEVE TË DREJTIMIT

Modele të lejeve të drejtimit të lëshuara në Shqipëri

Modeli i lejes në form karte (card) i leshuar në Shqipëri nga 1 korrik 2005

Modeli i lejes si letër, në fuqi nga 1 nëntori 1999, i konvertueshëm në Itali për një vit nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes

Modele të lejeve te drejtimit të lëshuara në Itali të renditur nga më i vjetri tek më i fundit

1) model i lejes së drejtimit MC 701/MEC. Autoriteti kompetent lëshues: Prefekti.

2) model i lejes së drejtimit MC 701/N. Autoriteti kompetent lëshues: Prefekti.

3) model i lejes së drejtimit MC 701/C. Autoriteti kompetent lëshues: Prefekti.

4) model i lejes së drejtimit MC 701/D. Autoriteti kompetent lëshues: Prefekti.

5) model i lejes së drejtimit MC 701/E. Autoriteti kompetent lëshues: M.C.T.C. (Motorizimi Civil dhe Transporte në Koncesion)

6) model i lejes së drejtimit MC 701/F lëshuar nga data 1 Korrik 1996 në bazë të Direktivës 91/439 KEE. Autoriteti kompetent lëshues: M.C.T.C..

7) model i lejes së drejtimit MC 701/F. Numërimi i të dhënave që përmban faqja 2 kundrejt modelit të treguar në pikën 6, ka ndryshuar.
Autoriteti kompetent lëshues: M.C.T.C..

8) model i lejes së drejtimit MC 720 F në bazë të Direktivës 96/47.
Autoriteti kompetent lëshues: M.C.T.C..

9) model i lejes së drejtimit MC 720 F në bazë të Direktivës 96/47.
Autoriteti kompetent lëshues: M.C.T.C. Dallon nga ai i mëparshëm sepse shprehja *"leje drejtimi"* shkruhet edhe në gjuhët e dhjetë Shteteve që kanë hyrë në Bashkimin Evropian më 1 maj 2004.

10) model i lejes së drejtimit MC 720 F në bazë të Direktivës 96/47.
Autoriteti kompetent lëshues: M.C.T.C. Dallon nga ai i mëparshmi në pikën 9), vetëm sepse numri i vulosur i sjellë në fund nga e djathta, pjesa e pasme e dokumentit, nuk është riprodhuar në vulë, por e realizuar në lazer e gdhëndur dhe kështu e ndjeshme në prekje.


LEJE DREJTIMI
REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE
TE TRANSPORTIT RRUGOR

Nr. 936810

DESHMI AFTESIE

PER DREJTIM AUTOMJETESH

Nr. 936810

EMRI _____

MBIEMRI _____

ATESIA _____

DATELINDJA _____

VENDLINDJA _____

VENDBANIMI _____

NENSHKRIMI I TITULLARIT TE AUTORIZUAR

(_____)

_____ me __/__/__

LLOJI I DESHMISE SE AFTESISE		KOHA E LESHIMIT	FIRMA, VULA
A	Motoriklete me peshe den 400 kg	Data Prot. Nr.	
B	Automjete, perjashto A, me peshe me mjaricese te plote 3500 kg, ose me tete vende perjashto drejtuesin	Data Prot. Nr.	
C	Automjete per transport mallrash me mjaricese te plote mbi 3500 kg	Data Prot. Nr.	
D	Automjete per transport personash me mbi tete vende perjashto drejtuesin	Data Prot. Nr.	
E	Automjete te kategorise B, C dhe D, per te cilat drejtuesi eshte afti sipas Fjalorjoje me rimorkio jo te lehte	Data Prot. Nr.	
F	Traktore me rota gome qe terheqin me rimorkio me peshe me mjaricese te plote jo me te madhe se peshe mjaricese terheqes	Data Prot. Nr.	

SHENIM: Automjetet ve te kategorise B, C dhe D mund te lejohet prapa me rimorkio e lehte, me kusht qe per kategorise B peshe e sajdhe e mjetit terheqes me mjaricese te plote te mos kaloje 1500 kg.


SOSPENSIONI DELLA PATENTE
CAMBIAMENTI DI RESIDENZA
Data
Firma
Data
Firma
E 0000000
VIDIMAZIONI ANNUALI
CONFERMA DI VALIDITÀ
Valida fino al
Data
Firma
REPUBBLICA ITALIANA
I
PATENTE DI GUIDA
Permis de Conduire
Driving Licence
Permiso de Conducción
Carta de Condução
Modello delle COMUNITÀ EUROPEE


1. Cognome
2. Nome
3. Data e luogo di nascita
4. Residenza
Via
Gruppo sanguigno
FIRMA DEL TITOLARE
UP MCTC di
5. Rilasciata dal Prefetto di
6. il
7. Valida fino al
8. Patente N.
IL PREFETTO
Categorie per le quali la patente è valida
A
B
C
D
E
INDICAZIONI ADDIZIONALI



SOSPENSIONI DELLA PATENTE

CAMBIAMENTI DI RESIDENZA

Timbro di convalida

Data

Firma

Data

Firma

E 0000000

Mod. MC 701/D

VIDIMAZIONI ANNUALI

CONFERMA DI VALIDITÀ

Timbro di convalida

Valida fino al

Data

Firma

FAC-SIMILE

REPUBBLICA ITALIANA

I

PATENTE DI GUIDA

Kørekort
Führerschein
Άδεια οδηγήσεως
Permiso de Conducción
Driving Licence
Permis de Conduire
Ceadúnas Tiománo
Elibewijs
Carta de Condução

Modello della
COMUNITÀ EUROPEE



1. Cognome
2. Nome
3. Data e luogo di nascita
4. Residenza
Via
Gruppo sanguigno

FIRMA DEL TITOLARE

Il Funzionario della Motorizzazione Civile

UP MCTC di

5. Rilasciata dal Prefetto di
6. il
7. Valevole fino al
8. Patente N.

IL PREFETTO

Marca da bollo e timbro

Categorie per le quali la patente è valida

Timbro di convalida

A

B

C

D

E

INDICAZIONI ADDIZIONALI


CONFERME DI VALIDITÀ
VIDIMAZIONI ANNUALI
REPUBBLICA ITALIANA
I
PATENTE DI GUIDA
CAMBIAMENTI DI RESIDENZA
SOSPENSIONI DELLA PATENTE
Körkort
Ajokortti
Άδεια οδήγησης
Permiso de Conducción
Driving Licence
Permis de Conduire
Carta de Conducere
Rijbewijs
Carta de Condução
Modello della COMUNITÀ EUROPEE
SPECIMEN


Categorie per le quali la patente è valida
A
B
C
D
E
INDICAZIONI ADDIZIONALI
FIRMA DEL TITOLARE
IL DIRETTORE


VIDIMAZIONI ANNUALI
CONFERME DI VALIDITÀ
REPUBBLICA ITALIANA
PATENTE DI GUIDA
CAMBIAMENTI DI RESIDENZA
SOSPENSIONI DELLA PATENTE
F 0000000
FAC-SIMILE


Categorie di veicoli per cui la patente è valida dal
INDICAZIONI ADDIZIONALI
FIRMA DEL TITOLARE
IL DIRETTORE
A
B
C
D
E


CONFERME DI VALIDITÀ
VIDIMAZIONI ANNUALI
REPUBBLICA ITALIANA
I
PATENTE DI GUIDA
CAMBIAMENTI DI RESIDENZA
SOSPENSIONI DELLA PATENTE
Karekart
Führerschein
Άδεια οδήγησης
Permiso de Conducción
Driving Licence
Permis de Conduire
Cedola unica Triennale
Rijbewijs
Carta de Condução
Modello delle
COMUNITÀ EUROPEE
E 0000000

FAC-SIMILE


1. Cognome
2. Nome
3. Data e luogo di nascita
4. Residenza
Via
Il Funzionario della Motorizzazione Civile
FIRMA DEL TITOLARE
5. Patente N.
6. Rilasciata dalla M.C.T.C. di
7. il
8. Valevole fino al
IL DIRETTORE
Importo di bollo annullato mediante versamento in c/c postale ai sensi dell'art. 7 della legge 18 ottobre 1977, n. 625
Categorie di veicoli per cui la patente è valida dal
A
B
C
D
E
INDICAZIONI ADDIZIONALI


PATENTE DI GUIDA
REPUBBLICA ITALIANA
1.
2.
3.
4a.
4c.
5.
7.
8.
9.
FACSIMILE


9.
10.
11.
12.
A1
A
B
C
D
CE
DE
AB 0000000
FACSIMILE


PATENTE DI GUIDA
REPUBBLICA ITALIANA
1.
2.
3.
4a.
4c.
4b.
5.
7.
8.
9.
SPECIMEN


9.
10.
11.
12.
A1
A
B
C
D
BE
CE
DE
AB 0000000


PATENTE DI GUIDA
REPUBBLICA ITALIANA
1
2
3
4a.
4c.
4b.
5.
7.
9.
8.
FAC-SIMILE


9.
10.
11.
12.
A1
A
B
C
D
BE
CE
DE
AA 0000000

REPUBBLICA DI ALBANIA
Ministero dei Lavori Pubblici, Trasporti e Telecomunicazione
Direzione Generale Servizi Trasporti Stradali

CERTIFICATO DI VALIDITÀ E AUTENTICITÀ DELLA PATENTE DI GUIDA N.....

) **DATI ANAGRAFICI DEL TITOLARE DELLA PATENTE:**

)OME_____ COGNOME_____

)ATA D` I NASCITA_____

UOGO DI NASCITA (con indicazione del comune e della nazione)_____

_____

) **TRADUZIONE DELLA PATENTE DI GUIDA** (allegata fotocopia fronte-retro)

RADUZIONE FRONTE PATENTE DI GUIDA

RADUZIONE RETRO PATENTE DI GUIDA

) **EVENTUALI PRESCRIZIONI:** (ad es. obbligo lenti, protesi acustiche, ecc.): _____

_____

) **La patente è autentica e in corso di validità. Scade il** _____

) **Data del primo conseguimento:**_____

) **La patente deriva* / non deriva* da conversione di altra patente estera rilasciata da**

_____

uogo e data

TIMBRO E FIRMA DEL FUNZIONARIO

*) barrare il caso che non ricorre

Da: ***Ministero dei Lavori Pubblici, Trasporti e Telecomunicazione***
Direzione Generale Servizi Trasporti Stradali – ALBANIA
Fax.n. _____

All' Ufficio Motorizzacione Civile di _____*(ITALIA)*

ATTESTAZIONE dei dati relativi alla patente di giuda albanese n.

1) DATI ANAGRAFICI DEL TITOLARE DELLA PATENTE:

NOME_____COGNOME_____

DATA DI NASCITA_____

LUOGO DI NASCITA (con indicazione del comune e della nazione)_____

2) EVENTUALI PRESCRIZIONI: (ad es. obbligo lenti, protesi acustiche, ecc.):_____

3) La patente è autentica e in corso di validità. Scade il _____

4) Data del primo conseguimento:_____

5) La patente deriva* / non deriva* da conversione di altra patente estera rilasciata da _____

Luogo e data

TIMBRO E FIRMA DEL FUNZIONARIO

(*) barraro il caso che non ricorre

Da: Ministero delle Infrastrutture e dei Trasporti D.G.Motorizzazione - Divisione 5 ITALIA - Fax.n. 0641586275

Ministero dei Lavori Pubblici, Trasporti e Telecomunicazione
Direzione Generale Servizi Trasporti Stradali ALBANIA – fax.n. 00355 4

ATTESTAZIONE dei dati relativi alla patente di giuda italiana n.

1) **DATI ANAGRAFICI DEL TITOLARE DELLA PATENTE:**

NOME_____

COGNOME_____

DATA DI NASCITA _____

LUOGO DI NASCITA (con indicazione del comune, della sigla della provincia e della nazione)

_____

2) **EVENTUALI PRESCRIZIONI:** (ad es. obbligo lenti, protesi acustiche, ecc.)_____

3) **La patente è autentica e in corso di validità. Scade il**

_____ .

4) **Data del primo conseguimento:**_____

5) **La patente deriva* / non deriva* da conversione di altra patente estera rilasciata da**

_____

Roma, (data)

FIRMA DEL FUNZIONARIO

(*) barraro il caso che non ricorre

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 26.12.2008
Doli nga shtypi më 29.12.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2008

Çmimi 40 lekë